



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:181857

Datë: 12.11.2024

Numri i dokumentit: 06441050

C.nr.545/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses Q.Knga Rahoveci, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson D.M, avokat në Prizren, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.O, avokat në Rahovec, me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 675.23 euro, jashtë seance, më datën 12.11.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditëses Q.K.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses Q.K nga Rahoveci, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit t’ia paguaj dhe atë: për periudhën kohore Qershor - Dhjetor 2021 në shumën prej 85.88 euro, si dhe për periudhën kohore Janar – Nëntor 2022 në shumën prej 537.19 euro, në shumën e përgjithshme prej 623.37 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 12.06.2024, deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

III. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses Q.K, në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë përtej shumës prej 623.37 euro e deri në shumën 673.23 euro, dhe atë në shumën prej 49.86euro.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses Q.K ti paguaj shumën prej 125.00 euro në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja Q.K nga Rahoveci, në këtë gjykatë me datë 12.06.2024, përmes të autorizuarit të saj D.M, avokat në Prizren, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit– Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se

paditësja është në mardhënie pune si tek e paditura, duke llogaritur prej hyrjes në fuqi të Kontratës , paditëses i ka takur e drejta e kompensimit për shkallën e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, në bazë të nivelit të shkallës së inflacionit ndër vite, kjo duke u bazuar në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës, të datës 22.01.2021, përkatësisht neni 35 par 10, ku punëdhënësi ka pasur për obligim që për çdo vit të pëcjellë shkallën e inflacionit dhe përqindjen e inflacionit, por që deri më tani nuk është kompensuar. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta aprovojë në tërsi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 07.10.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, pasi që të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv në këtë çështje kontestimore, padia është e pathmeltë dhe e pa bazuar ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit DKA, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën është thirrur pala paditëse nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore. Kërkesëpadinë e paditëses e konteston në tërësi edhe mbi bazën që më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Paditësi ka parashtruar padi në këtë gjykatë me datë 12.06.2024, andaj konsideron që kërkesëpadia e paditëses është parashkruar në tërsi ngase nga hyrja në fuqi e KKAK, të datës 18.04.2017 deri në parashtrimin e padisë në këtë gjykatë kanë kaluar më shumë se 3 vite.

Në bazë të nenit 87 të Ligjit të punës “Të gjitha kërkesat në para nga mardhënia e punës parashkruhen në afat prej tre (3) vitesh. Paditësi ka parashtruar padi në këtë gjykatë me datë 04.01.2024, andaj konsiderojmë që kërkesëpadia e paditësve është parashkruar në tërsi ngase nga hyrja në fuqi e KKAK, të datës 18.04.2017 deri në parashtrimin e padisë në këtë gjykatë kanë kaluar më shumë se 3 vite. Paditësit nuk i kanë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative, e që gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësi i ka shtjerrë të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ.

Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8, 398 dhe 399 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditësen të lëshuar nga Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën SH.F.M.U “Vëllezërit Frashëri”, në fshatin Drenoc, komuna e Rahovecit. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës

për vitin 2021 vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumën prej 421.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses Q.K, i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (datë e parashtrimit të padisë), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 12.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata vlerëson se baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa për këtë periudhë kohore nuk është parashkruar pasi që padia është parashtruar me datë 12.06.2024.

Sa i përket pjesës refuzuese gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata për këtë çështje ka vlerësuar se si moment/periudhë e rrjedhës së kamatës për kërkesat regresuese të kreditorit, duhet të merret data e parashtrimit të kërkesës së kreditorit tek debitori (data e pranimit të kërkesës nga ana e debitorit), apo data e parashtrimit të padisë në gjykatë për rastet kur kreditori nuk ka paraqitur paraprakisht një kërkesë të tillë tek debitori. LMD me dispozitën e nenit 382 paragrafi 1 ka përcaktuar detyrimin e pagesës së kamatëvonesës:

*“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”, ndërsa në paragrafin 2 të të njëjtit nen është përcaktuar se: “Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”. Në rastin konkret, duke qenë se debitori vetëm në momentin e pranimit të padisë nga gjykata është njohur me përmbajtjen e detyrimit për pagesën e kërkesës regresuese të kreditorit, gjykata si moment të rrjedhjes së kamatës së kreditorit ka marrë datën 12.06.2024, kur është parashtruar padia dhe mbi këtë bazë ka refuzuar shumën prej 49.86 euro, si shumë e kamatës vjetore, e cila ishte paraqitur bashkë me kërkesën kryesore si vlerë e përgjithshme.*

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta refuzojë pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjukata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjukata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 21 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 125.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil  
C.nr.545/2024, më datën 12.11.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale  
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari  
Avni Berisha

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.